

Programi i ngritjes se kapaciteteve Për nxitësit e Iniciativave për Zhvillim të Qëndrueshëm në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna

Zhvillimi i qëndrueshëm alpin përmes shoqërisë civile, Qendrës për Edukim Mjedisor dhe Iniciativave Rurale

Prapavija

Ky program i ngritjes së kapaciteteve është pjesë e projektit, “Zhvillimi i qëndrueshëm alpin përmes shoqërisë civile, Qendrës për Edukim Mjedisor dhe Iniciativave Rurale”, që implementohet nga Environmentally Responsible Action group (ERA) në Pejë dhe partnerët e saj ndërkombëtar, TreeVelop Projects & Processes dhe Global Action Plan International (GAP). Rezultati kryesor i këtij projekti është jetësimi i Qendrës për Edukim Mjedisor në Pejë, në Mullirin e Haxhi Zekës. Rezultati i dytë i parashikuar është implementimi i 6-8 Iniciativave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Bjeshkët e Nemuna. Këto iniciativa do të realizohen përmes skemës së granteve të vogla. Në mënyrë që ti ndërtoj kapacitetet e iniciatorëve potencial është dizajnuar një program trajnimi 5 ditor.

Qëllimi i këtij programi trajnues është ngritja e njohurive dhe të kuptuarit e implementimit praktik për iniciativat e qëndrueshme zhvillimore në zonat rurale apo regjionet alpine.

Pjesëmarrësit mësojnë nga studime të rasteve të suksesshme në vende të tjera, marrin prapavijen e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm, punojnë në grup rreth ideve të projekteve të tyre, ngrisin kapacitetet komunikative dhe bashkëpunimin në mes grupeve të ndryshme, ngrisin njohuritë e tyre për zhvillimin e projekteve dhe shkrimin e projekt propozimit (përfshirë planifikimin dhe shkruarjen e buxhetit).

Pjesëmarrësit në këtë program trajnimi janë të ftuar përmes një thirrje të hapur aplikimi. Procedurat janë të shënuara me poshtë.

Grupi i synuar – Pranueshmëria

Kandidatët e mundshëm nga grupet e synuara në vijim janë të ftuar të aplikojnë:

- Qytetar aktiv duke jetuar ose punuar në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna që dëshirojnë regjionin alpin të jetë i mbrojtur dhe i zhvilluar vetëm në mënyrë të qëndrueshme;
- Aktivistët e shoqërisë civile dhe anëtar të OJQ-ve aktive që promovojnë jetesën në Bjeshkët e Nemuna dhe/ose që llojnë për mbrojtje më të fortë të thesareve alpine të Kosovës.

Në mënyrë të veçant kandidatët femra dhe të rinjtë janë të inkurajuar të aplikojnë.

Që të jeni i/e pranueshëm/e duhet të aplikoni me një iniciativë konkrete ose ide projekti për zhvillim të qëndrueshëm në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna. Për iniciativë apo projekt që dy vetë punojnë së bashku do të pranohen në programin trajnues. Kjo nënkupton, se ju aplikoni në grupë prej dy vetë (dhe jo si individ, derisa qart nuk mund ta arsyetoni këtë).



ERA group është e gatshme t'ju **ndihmoj** me plotësimin e aplikacionit tuaj nëse ju duhet ndonjë ndihmë!

Përmbajtja e programit Trajnues

Programi trajnues përmban dy trajnime që do të organizohen në Pejë dhe një detyrë shtëpie gjatë kohës në mes të dy trajnimeve. Trajnimi i parë zgjatë 3 ditë, ndërsa i dyti do të ketë 2 ditë të plota pune.

Trajnimi i parë do ti përgjigjet pyetjeve të mëposhtme në mënyrë praktike dhe me metodën e të mësuarit duke bërë:

- Në cilat iniciativa për zhvillim të qëndrueshëm njerëzitet në Bjeshkët e Nemuna janë duke punuar dhe menduar?
- Çfarë është qëndrueshmëria dhe si është aplikuar në një sërë vendesh rurale në Europë?
- Si një jetesë e qëndrueshme në një fshat alpin duket në realitet?
- Pse zhvillimi i qëndrueshëm është i rëndësishëm në Bjeshkët e Nemuna?
- Çfarë mund të bëni në fshatin tuaj që të krijoni bazat për zhvillim të qëndrueshëm praktik?
- Si mund të ndjeheni të fortë dhe të guximshëm për të folur për zhvillim të qëndrueshëm?
- Si mund të komunikoni në mënyrë efektive me grupe të interesit, si partnerë potencial për projekte, autoritetet lokale, sipërmarrësit, etj...?
- Cfarë është një projekt i zhvillimit të qëndrueshëm dhe si të zhvillohet një koncept projekti?

Detyra e shtëpisë ndërmjet dy punëtorive konsiston në zhvillimin e mëtejshëm të iniciativës tuaj për zhvillim të qëndrueshëm alpin në një koncept mirë të strukturuar dhe të qartë.

Punëtorja e dytë do të përqendrohet në zhvillimin e projektit, hartimin e propozimit si dhe këshilla rreth implementimit të projektit. Punëtorja përfshin pikat e mëposhtme:

- Karakteristikat e një ekipe të suksesshme
- Fazat e projektit
- Afatet kohore dhe plani i punës
- Planifikimi i Bugjetit
- Si të hartojmë një projekt propozim të plotë
- Komunikimi me donatorët
- Ngritja e një ekipe pune dhe mbajtja e motivit në ekip
- Raportimi dhe këshilla

Pas punëtorisë së dytë pakoja e aplikimit për programet e granteve e vogla në mbështetje të iniciativave për zhvillim të qëndrueshëm alpin në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna do të shpërndahen.

Certifikata e UNESCO-s

ERA dhe GAP International pajisë me certifikatë të autorizuar të UNESCO-s të gjithë pjesëmarrësit të cilët do të marrin pjesë në të gjitha ditët e Trajnimit dhe kanë dorëzuar detyrën e shtëpisë në kohë dhe me cilësi të lartë.

Kohëzgjatja dhe vendi

Programi trajnues është i ndarë në dy sesione trajnime me një detyrë shtëpie ndërmjet tyre. Trajnimi i parë do të mbahet në datat: **26 e enjte, 27 e premte, dhe 28 e shtune-Janar 2012**. Trajnimi i dytë mbahet në datat: **7 e mërkurë dhe 8 e enjte-Mars 2012**

Programi trajnues do të marr **5 ditë të plota pune**, përfshirë edhe kohën e **përkushtimit serioz në detyrën e shtëpisë**. Detyra duhet të dorëzohet në **mesin e shkurtit 2012**. Data e saktë do të kumtohet me përfundimin e trajnimit të parë.

Të dy punëtoritë do të mbahen në Pejë. Për pjesëmarrësit tjerë, jashtë qytetit të Pejës, shpenzimet e rrugës do të mbulohen. Kafja/çaji dhe dreka gjatë ditëve të trajnimit do të mbulohet nga ERA. Në rast së është e nevojshme që dikush të qëndroj gjatë natës në Pejë ERA mbulon edhe shpenzimet e akomodimit dhe darkës.

Mënyra e aplikimit në Programin për Ngritje të Kapaciteteve

Në programin për ngritje të kapaciteteve, Ju aplikoni me përshkrimin dhe dorëzimin e iniciativës tuaj rreth zhvillimit të qëndrueshëm alpin dhe një letre motivuese më se largu të **premtën, 20 janar 2012**.

Aplikoni më një iniciativë konkrete apo ide projekti. Për një iniciativë apo projekt ide **dy aktivistë** do të marrin pjesë në trajnim, që do të thotë Ju aplikoni si grup, që do të punoni në iniciativat e juaja.

Pakoja komplete e aplikimit duhet të përbëhet nga:

1. Dy faqe përshkrim të iniciativës për zhvillim të qëndrueshëm në dhe/ose për regjionin e Bjeshkëve të Nemuna. Shpjego shkurt pikat:
 - Çfarë është ajo që ju dëshironi të bëni
 - Si planifikoni ta bëni atë
 - Kur keni ndërmend të punoni
 - Pse mendoni se kjo duhet bërë
 - Me kë jeni duke punuar në iniciativë
 - Për kë jeni duke punuar në këtë iniciativë
2. Për individ aktiv me iniciativën për zhvillim të qëndrueshëm alpin duhet një aplikim e mbuluar me të dhënat e më poshtme:
 - Emri i plotë
 - Organizata/at – nëse jeni i lidhur në me shumë se një OJQ
 - Numër telefoni mobil
 - Adresë elektronike (e-mail) dhe kontaktet ne Facebook
 - Data e lindjes
 - Arsimimi ose përvoja profesionale
 - Motivimi përsonal që të punoni në iniciativa për zhvillim të qëndrueshëm në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna (maksimum një letër A4 për person)

Karakteristika dhe shembuj nga iniciativa për zhvillim të qëndrueshëm alpin

Në kuader të projektit 'Zhvillimi i Qendrueshëm Alpin në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna' është synim mbështetja e një numër i iniciativave për zhvillim të qëndrueshëm alpin. E këto iniciativa duhet të ndjekun këto karakteristika:

- Të zbatohet në Bjeshkët e Nemuna dhe/ose plotësisht të përqendrohet në zgjidhjen e problemeve mjedisore ose ngritjen e statusit në mbrojtjen e Bjeshkëve të Nemuna
- Të ketë ndikim afatgjatë për Bjeshkët e Nemuna, banorët dhe biodiversitetin:
 - Siguroj rezultate konkrete, si:
 - Rritja e mbrojtjes natyrore dhe biodiversitetin;
 - Promovimi dhe praktimi i jetesës së qëndrueshme

- Zhvillimi i qendrueshëm i grave dhe në mënyrë specifike i të rinjëve
- Të zbatohet në periudhën **Qershor – Dhjetor, 2012**

Janë shumë iniciativa për zhvillim të qendrueshëm që mund ti mendoni. Nevojat në Bjeshkët e Nemuna janë shumë të mëdha. Me poshtë janë disa shembuj iniciativash për zhvillim të qendrueshëm alpin, të cilat janë vetëm tregues të mundësive, andaj **MOS I KOPJONI** dhe thjesht ti vëni në aplikacionin e juaj.

Disa nga shembujt do mund të ishin (ndër të tjera)

- Aktivitete për pyje të qendrueshme, duke përfshirë parandalimin e prerjeve dhe gjuetinë ilegale, mbjelljen e llojeve të ndryshme të pemëve në shpatet ku janë prerë pemet, lisat, etj..;
- Zhvillimi në masë të vogël i iniciativave të qendrueshme të familjeve që veprojnë me qëllim, p.sh. ushqimi tradicional lokal, hotelieri ose punë dore nga materiale natyrore ose produkte frutave të egra të zgjedhura;
- Iniciativa për turizëm të qendrueshëm, përfshirë mundësimin e programve/aktiviteteve në natyrë, sportive në mënyrë të qendrueshme (përdorim të qendrueshëm i energjisë, transport të qendrueshëm dhe hotelieri, etj..);
- Fushata dhe lobime për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, duke përfshirë zbatimin e mbrojtjes në pjesët e mbrojtura të Bjeshkëve të Nemuna.

Ju lutem keni parasysh:

- Iniciativat e **grave** dhe **të rinjëve** që jetojnë dhe punojnë në Bjeshkët e Nemuna do të kenë përparësi.
- Aplikimi në programin e granteve për iniciativat e zhvillimit të qendrueshëm do të jetë në dispozicion me **8 Mars, 2012**.
- Nuk ekziston garanci se pjesëmarrësit që marrin pjesë në programin trajnues të jenë edhe fitues të granteve, megjithatë, pjesëmarrësit aktiv do të duhej të kenë shansin e madh që të fitojnë grant në kuadër të programit të granteve për zhvillim të qendrueshëm.